



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 28, nenit 29 paragrafi (1), neni 34, nenin 35 paragrafi (5), nenin 54 paragrafi 2.3, i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare Nr. 88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në kërkesën e IPKO Telecommunication Sh.p.k. e datës 20.04.2017, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në Mbledhjen e mbajtur më 20.02.2018 merr këtë:

K O N K L U Z I O N

- I. Konstatohet, se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore kundër Marrëveshjes së Telekomit të Kosovës Sh.a. (VALA) dhe Dardafon.net Sh.p.k (Z-Mobile).
- II. Marrëveshjet në mes të MNO-ve dhe MVNO-ve janë të rregulluara nga rregullatorët dhe ligjet në fuqi.
- III. Ky Konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me datën 20.04.2017, ka pranuar kërkesën me nr. prot. 88/17-02/H nga kompania IPKO Telecommunications Sh.p.k. (*këtu e tutje referuar si IPKO*) me pretendimin e IPKO-së për shqyrtim paraprak - vërtetimin e shkëljes së Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës të marrëveshjes së palejuar në mes të Telekomit të Kosovës Sh.a. (*këtu e tutje referuar si VALA*) dhe Dardafon.net Sh.p.k. (*këtu e tutje referuar si Z – Mobile*).

P R E T E N D I M E T E I P K O - s ë

IPKO ka parashtruar padi kundër VALA dhe Z-Mobile për kompenzim të dëmit të shkaktuar IPKO-së si rezultat i Marrëveshjes së nënshkruar në mes tyre, në gjykatat kompetente të Republikës së Kosovës, me pretendimin e saj se kjo Marrëveshje është e palejuar sipas nenit 4.1 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

PËRKUFIZIMI I MARRËVESHJEVE SIPAS LIGJIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 1 par. 1.1 e definojnë përkufizimin e marrëveshjeve, si në vijim: **“Marrëveshje - marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikën e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, ose në nivele të ndryshme, të tregut”**

ndërsa,

-neni 4 i Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës e definojnë se cilat marrëveshje janë të ndaluara, si në vijim: **“Ndalohe të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marrura në mes të shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikën e bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant”**

Duke u bazuar në Udhëzimet Administrative Nr.03./2017 dhe Nr. 02/2017 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës definojnë marrëveshjet vertikale dhe horizontale si në vijim:

Marrëveshje vertikale - është kontratë, ndonjë dispozitë e kontratës, marrëveshjet gojore ose me shkrim, praktikën e bashkërenduara që rezultojnë në marrëveshje të tilla, vendimet nga ndërmarrësit ose shoqatat e ndërmarrësve, kushtet e përgjithshme dhe aktet tjera të ndërmarrësve, të cilat janë ose mund të jenë pjesë përbërëse e kontratës, të lidhura ndërmjet palëve **që nuk veprojnë në të njëjtin nivel të prodhimit ose të shpërndarjes**, e të cilave i'u parashtrihen kushtet me të cilat pjesëmarrësit në marrëveshje mund të blejnë, shesin apo rishesin mallra dhe/ose shërbime të caktuara.

Marrëveshje horizontale - është kontratë, një dispozitë e caktuar e kontratës, marrëveshje me gojë apo me shkrim, praktikën e bashkërenduara që rezultojnë nga marrëveshje të tilla, vendime të ndërmarrësve apo të grupeve të ndërmarrësve, kushtet e përgjithshme të biznesit dhe aktet tjera të ndërmarrësve, që janë ose mund të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes dhe të ngjashme, të arritura ndërmjet dy apo më tepër ndërmarrësve të pavarur **të cilët veprojnë në nivel të njëjtë të prodhimit, gjegjësisht distribuimit**, dhe të cilëve u rregullohen kushtet me të cilët palët e marrëveshjes mund të blejnë, shesin apo rishesin mallrat dhe/apo shërbimet e caktuara;

KORNIZA LIGJORE NGA ANA E RREGULLATORIT

Bazuar në dokumentin e ARKEP të aprovuar me datën 29 Maj 2008 me Nr. Prot. 110/08 “KORNIZA E NDRYSHUAR PËR OPERATORËT E RRJETËS VIRTUALE MOBILE (Ang. MVNO) paragrafi 3.4, citoi: **“Çfarë do marrëveshje operacionale/komerciale në mes të MNO-së dhe MVNO-së duhet të jetë subjekt aprovimi nga ART, për arsye se duhet që të sigurohet që marrëveshja e caktuar nuk është në kundërshtim me ligjet në fuqi, rregulloret në fuqi si dhe termet e Licencës. Marrëveshja në mes MNO dhe MVNO nuk duhet që të jetë e plotfuqishme pa aprovim nga ART-ja. Nëse ART-ja nuk jep vërejtje me shkrim në afatin prej 15 ditëve nga data e marrjes së marrëveshjes që është arritur në mes MNO-së dhe MVNO-së, marrëveshja do të konsiderohet e plotfuqishme në mënyrë automatike”**.

Ndërsa paragrafi 3.3 i po të njejtit dokument, citoi: “MNO dhe MVNO duhet të jenë të lira të negociojnë modelin i cili më së miri i’a plotëson interesat dhe strategjitë biznesore, rrjedhimisht më shumë se një lloj i MVNO-ve mund të implementohet në Kosovë, varësisht se sa MVNO-ja dëshiron të mbështetet në infrastrukturën e MNO-së, varësisht prej segmentimit të tregut si dhe nga pakoja e produkteve të propozuara për të cilat është arritur pajtueshmëri midis MNO-së dhe MVNO-së”.

Marrëveshjet komerciale në mes MNO-ve dhe MVNO-ve në parim janë të lejuara sipas Ligjit 04/L-109 për Telekomunikime Elektronike si dhe KORNIZA E NDRYSHUAR PËR OPERATORËT E RRJETËS VIRTUALE MOBILE e datës 29 Maj 2008 Nr. prot. 110/08.

KËNDVËSHTRIMI I AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURENCËS

Marrëveshjet nga Autoriteti trajtohen si raste *in perse* (shkelje në vetvete), ndërsa për keqpërdorimin e Pozitës Dominuese vlen rregulli *rule of reason* (rregullat e arsyes), se çfarë u tha më lartë, marrëveshja MNO dhe MVNO janë marrëveshje të rregulluara me ligje dhe akte nënligjore si dhe direktivat ndërkombëtare. Këto marrëveshje janë të rregulluara nga rregullatori përkatës e si të tilla në parim nuk bien ndesh me rregullat e konkurrencës.

Autoriteti thekson se çdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve, të cilët janë potencial për t’u angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (*numerus clausus*) në përgjithësi është e padëshirueshme nga pikëpamja e konkurrencës.

Përfundimisht, këto marrëveshje i’u mundësojnë MVNO-ve që të hyn në konkurrencë me operatorët ekzistues, jo vetem në aspekt të çmimeve por edhe në aspektin e llojeve të produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, siguron që pjesëmarrësit në një treg të kenë qasje të barabartë dhe të lirë, të jenë të pavarur, caktimi i çmimit të jetë i bazuar kryesisht në ofertë dhe kërkesë dhe të konkurrojnë njëri tjetrin me cilësi të shërbimeve dhe produkteve.

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 5 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës vlerëson se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore dhe u vendos si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- *Arhiva*
- *Publikohet në web faqen e Autoritetit*
- *Palët*

AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
KOMISIONI

(_____)

Valon PRESTRESHI

Kryetar

(_____)

Ahmet KRASNIQI

Zv. Kryetar

(_____)

Fatime HAZIRI

Anëtare

(_____)

Shaqir MORINA

Anëtar

(_____)

Muhamed KRASNIQI

Anëtar